

SHPALLJE PËR INSPEKTORË JOMAGJISTRATË, NJËSIA E INSPEKTORËVE PRANË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpall procedurën për:

5 (pesë) Inspektorë Jomagjistratë, Njësia e Inspektorëve, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë – Kategoria G-2

Afati për dorëzimin e dokumentacionit: 25.06.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin

Inspektori kryen verifikime dhe hetime administrative rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Në ushtrimin e detyrës së tij, inspektori mbledh të dhëna dhe vlerëson çdo informacion, ose akt që çmon se është, ose mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

1.1 KUSHTET DHE KRITERET

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të misionit të veprimtarisë hetimore fton të gjithë personat e interesuar të aplikojnë për vendet vakante për pozicionin “Inspektor Jomagjistrat”, të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;

- b) Të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;
- c) Në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;
- d) Në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;
- e) Të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- f) Të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- g) Të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;
- h) Të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
- i) Të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

1.2 DOKUMENTACIONI PARAPRAK, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme në kopje origjinale ose të vërtetuar sipas ligjit:

- a- Kërkesë për shprehje interesi në pozicionin e shpallur;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në rubrikën “Njoftime”; “Rekrutim Inspektor Jomagjistrat”; kategoria “Autorizime/deklarata/informacione”, të gjendur në linkun: <https://ild.al/sq/rekrutim-inspektore-jo-magjistrate/>
- c- Dokumentin që përshkruan motivimin e kandidimit dhe objektivat nëse emërohet;
- d- Diploma dhe lista e notave (përfshirë diplomën bachelor dhe listën e notave). Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- e- 5 (pesë) dokumente profesionale të cilat do të shërbejnë për vlerësim sipas metodologjisë së miratuar;
- f- Deklarimin, nëse zotëron, njohuri të gjuhëve të huaja (një nga gjuhët e Bashkimit Evropian), të shoqëruar, nëse disponohen, me dokumente përkatëse vërtetuese të lëshuara nga subjekte publike ose private të specializuara dhe të noterizuara;
- g- Libreza e punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë si jurist)/ndërsa për vitet e punës si jurist, që nuk janë të shënuara në librezën e punës, të përcillet vërtetimi i lëshuar nga punëdhënësi (pozicioni/lloji i punës/data e fillimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës) të shoqëruar me vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- h- Vërtetim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, që vërtetohet se në kohën e kandidimit të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;
- i- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- j- Vërtetim nga gjykata e shkallës së parë e juridiksionit të përgjithshëm;
- k- Vërtetim nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë së juridiksionit të përgjithshëm;
- l- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);

- m- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, në linkun: <https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- n- Rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm;
- o- Kandidatët mund të dorëzojnë çdo dokument tjetër, të cilat gjithashtu duhet të jenë në kopje origjinale ose të vërtetuara sipas ligjit, që shërben për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””, që gjendet në rubrikën “Legjislacioni”, kategoria “Akte të Inspektorit të Lartë”, në linkun: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>.

Dokumentacioni i lartpërmendur, duhet detyrimisht të përcillet brenda afatit të përcaktuar në dokumentin e shpalljes. Çdo dokument tjetër, i përcjellë pas këtij afati, nuk do të përfshihet gjatë shqyrtimit të aplikimeve.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në adresën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë, brenda datës **25.06.2026**.

Të gjitha njoftimet drejtuar kandidatit jomagjistrat gjatë procedurës së verifikimit do të bëhen me shkresë, në adresën postare ose në adresën elektronike të deklaruar për këtë qëllim nga kandidati.

Për çdo pyetje, apo sqarim shtesë, kandidatët janë të lutur t’i përcjellin përmes adresës elektronike të vendosur për këtë qëllim: inspektorjomagjistrat@ild.al.

Për kriteret, kushtet dhe procedurat e rekrutimit të inspektorëve jomagjistratë do të zbatohen parashikimet e VKM nr. 536, datë 25.07.2019 “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

Për më shumë informacion lidhur me shpalljen dhe kriteret e kualifikimit, klikoni në linkun: <https://ild.al/sq/rekrutim-inspektore-jo-magjistrate/>